



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351/02-57417
Dt. 19.05.2025
Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesë së **Xhemali,Ruzhdi,Imri,Fatmir,Nexhmedin,Rahim,Afrim Susuri nga fsh Zhur me Deklarate me LRP-nr.3286/2024, me Deklarate meLRP nr.16942/2024 dhe Autorizim me LRP nr.8050/2023 noter Bilgaip Maznikar në bazë të nenit 3 alineja 1pika 7 e lidhur me nenin 17 dhe 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-212 dt. 31.07.2013, si dhe nenit 3 alineja 1pika1.1,1.4,1.7,1.10,1.17,1.20,1.21 dhe te nenit 5alineja1pika 1.1si dhe nenit 14 alineja 1pika 1.1 dhe ne lidhje me nenin 15 alineja 1 pika1.2 dhe nenit 19 alineja 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe dhe sipas vendimit per miratimin e HZK per peridhen 2022-2030 Nr.001-011-48192 te dt 31.03.2022, si dhe nenit 85 te LVL dhe te nenit 27,44,46,47,48 si dhe te nenit 125 te LPPA nr.05/031 dt.25.05.2016 si dhe konform nenit14,15,16,17 dhe 18 te Udhezimit Administrativ nr.06.2017 dt.23.05.2017 si dhe konform nenit 4 pika6.1,paragrafi 2dhe paragrafi 14 si dhe konform nenit 34 e Rregullores për taksa Komunale nr.001/011-99275 dt.30.06.2022 dhe Vendimit per percaktimin e Takses administrative per leshimin e lejes ndertimore dhe tarifa per rregullimin e infrastruktures ne teritorin e qytetit te prizrenit nr.01/011-41141 te dt.10.04.2014 merr kete:**

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Xhemali,Ruzhdi,Imri,Fatmir,Nexhmedin,Rahim,Afrim Susuri		
Adresa:	Rruga “Prizren-Vlashnje“		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti – afarist		
Emri i projektuesit	Biro projektuese “Pika Design” SHPK		
Adresa:	/////		
Telefoni:	044//	Emaili:	pikadesign2020@gmail.com

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Xhemali, Ruzhdi, Imri, Fatmir, Nexhmedin, Rahim, Afrim Susuri** i lejohet ndërtimi i objektit- afarist **B+P+1** ne rr. "Prizren-Vlashnje", pn.// me numer ngastres P-71813006-00745-2Z.K.Vlashnje.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren, "///", pn.//	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në ë Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar (ZK) tregtar depo afarizem.</p> <p>Objekti – afarist do të ndërtohet në parcelën P-71813006-00745-2 Z.K.Vlashnje, me sip.4162m²(3553m²) me dimensione sipas kopjes së planit.</p> <p>Etazhiteti i objektit do të jetë B+P+1.</p> <p>Sipërfaqja bruto e bodrumit është S=310.0m².</p> <p>Sipërfaqja neto e bodrumit është S=289.9m².</p> <p>Sipërfaqja bruto e përdhesisë është S=321.9m².</p> <p>Sipërfaqja neto e përdhesisë është S=298.3m².</p> <p>Sipërfaqja bruto e katit I është S=365.4m².</p> <p>Sipërfaqja neto e katit I është S=340.8m².</p> <p>Sipërfaqja bruto e objektit është S=997.3m²(sipas lejes) dhe per pagese.</p> <p>Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 4178.68 €.</p> <p>Vlera e objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 312,618.50€</p>	GPS Koordinatat:

/s/ ...

--	--	--

Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtimi i ri	<input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/>
		Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:		
Kategoria I		Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Përdorimi i propozuar:objektit- afarist		

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Xhemali, Ruzhdi, Imri, Fatmir, Nexhmedin, Rahim, Afrim Susuri** i lejohet ndërtimi i objektit- afarist **B+P+1 rr."Prizren-Vlashnje",pn.//**
Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vëlosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuar nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriat i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;

- Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Xhemali, Ruzhdi, Imri, Fatmir, Nexhmedin, Rahim, Afrim Susuri** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin – afarist** . Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:


- Njoftim për plotësim të dokumentacionit
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Vertetim nga sektori i menaxhimit të mbeturinave nga Ekorogjioni.
- Pëlqimi nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
- Pëlqim nga KRUDukagjini-Radomiqi”SH.A.Gjakove.
- Leja Mjedisore Komunale.
- Pëlqimi i DSHP-se nga sektori i komunikacionit për qasje
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike – për Kategorinë e II-te

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.


DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-57417

Bashkepunetor profesional:



Zana Belloda inxh.dip.ark.



DREJTORI:



Pranverim Berisha, jur.

REPUBLIKA E KOSOVES
DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR